



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201900918/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** *Rekomandim për fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Durrës për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.*

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR**  
**Durrës**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT**  
**Tiranë**

**Për dijeni:** **DREJTORISË VENDORE TË POLICISË**  
**Durrës**

*Të nderuar,*

Më datë 19.07.2019, shtetasja E.L nga Tirana, ka paraqitur ankesë në institucionin e Avokatit të Popullit, në të cilën shprehet se më datë 14 korrik 2019, punonjës të policisë së Komisarariatit të Policisë Durrës, kanë ushtruar dhunë fizike ndaj dy nipërve të saj shtetasve, R.M dhe K.M (i mitur me moshë 16 vjeç), që ishin duke udhëtuar me një makinë, në një nga rrugët e qytetit të Durrësit. Sipas znj. L., punonjësit e policisë kanë ushtruar dhunë fizike ndaj shtetasve R dhe K.M, në momentin e shoqërimit, si edhe brenda dhomave të shoqërimit, të Komisarariatit të Policisë Durrës.

Në datë 14 korrik, znj.L pas komunikimit me të afërmit, ka shkuar për të takuar motrën dhe nipërit e saj në Durrës, ku dhe ka parë se K. kishte shenja në fytyrë, sytë e nxirë dhe një çarje në vetullën e djathtë.

Mbi këtë ankesë, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, në kuadër të së cilit ndihmëskomisionerët e Seksionit të Veçantë kanë shkuar në qytetin e Durrësit, përkatësisht në datat 19 dhe 23 korrik 2019, ku dhe janë kryer veprimet e nevojshme hetimore si: marrja e deklarimeve të personave të dëmtuar R dhe K.M, si dhe prindërve të tyre S dhe V.M. Në kuadër të një hetimi të gjithanshëm dhe sa më objektiv janë marë deklarime edhe të punonjësve të policisë së Komisarariatit të Policisë Durrës Klaosjent Aliaj, Hysen Shehi, Kastriot Karafili dhe Pjerin Prenga.

Në Komisariatin e Policisë Durrës, u bënë verifikimet e nevojshme në dokumentacionin e administruar. Konkretisht janë administruar kopje të fletëve të regjistrave, për personat e shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar, raporti i shërbimit i datës 14.07.2019, i përpiluar nga punonjësit e policisë Hysen Shehi, Klaosjent Aliaj, Ernest Goxhi dhe Sara Bushi.

Nga këqyrja e regjistrit rezulton se shtetasi K.M figuron i regjistruar si person i shoqëruar në Komisariatin e Policisë Durrës më datë 14.07.2019, ora 16<sup>30</sup>, për "*Kundërshtim të punonjësit të policisë*" dhe në orën 22<sup>15</sup> të po kësaj date është lënë i lirë.

Ndërsa, shtetasi R.M është shoqëruar në polici më datë 14 korrik 2019, ora 16<sup>30</sup> si person i dyshuar për "*Kundërshtim të punonjësit të policisë*" dhe po në këtë datë ora 23<sup>00</sup>, është arrestuar. Me vendimin nr.191, datë 17.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shtetasi R.M është lënë i lirë, pasi ndaj tij është vendosur masa e sigurimit "*Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*".

Pas, disponimit të akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, të kryera ndaj shtetasve K dhe R.M si dhe të punonjësve të policisë, Klaosjent Aliaj dhe Hysen Shehi nga mjeku ligjor në qytetin e Durrësit, në konkluzionet përkatëse ka rezultuar si më poshtë:

- Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.302, datë 15.07.2019, bëhet fjalë se në trupin e shtetasit K.M konstatohet "*zonë ekimotike poshtë dhe rreth syrit të djathtë me ngjyrë mavi me përmasat 6x2.6 cm. Në vetullën e majtë anash, vërehet një plagë dërmishje me gjatësi 1.6 cm*".

- Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.303, datë 15.07.2019, për shtetasin R.M përshkruhet "*një zonë ekimotike përreth syrit të majtë me ngjyrë mavi me përmasa 12x2.6 cm*".

- Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.301, datë 15.07.2019, për shtetasin S.M përshkruhet "*zonë dërmishje në gjurin e djathtë dhe në gjurin e majtë me ngjyrë si të ndryshkut me përmasa 3x4 cm*".

- Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.306, datë 15.07.2019, për shtetasin Hysen Shehi "*vërehen 12 gërvishje paralele njëra me tjetrën në krahun, parakrahun e djathtë me gjatësi më e madhja 7cm, më e vogla 4 cm. Në anën e djathtë të gjoksit vërhen 3 gërvishje paralele me njëra-tjetrën, me gjatësi njëra 4 cm, 5 cm dhe 6 cm*".

- Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.307, datë 15.07.2019, për shtetasin Klaosient Aliaj, *“vërehen në 1/3 e poshtme të parakrahut të majtë katër gërvishtje paralele me njëra-tjetrën me gjatësi nga 6 cm. Në parakrahun e djathtë në 1/3 e poshtme, vërehen tre gërvishtje paralele me njëra-tjetrën me gjatësi nga 5 cm. Në krahun e djathtë vërehen tre gërvishtje me gjatësi 7 cm”*.

Nga aktet e ekspertimit të përmendura më lart, rezulton se dëmtimet e konstatuara tek këta persona, nuk kanë sjellë humbje të përkohshme të aftësisë për punë.

Në deklaratimet e tyre shtetasit K dhe R.M, sqarojnë se në ditën e ngjarjes, konkretisht në datë 14 Korrik 2019, rreth orës 16<sup>30</sup>, po shkonin për në shtëpi me mjetin e punës së R, të cilin po e drejtonte ky i fundit. Në afërsi të ish stacionit të policisë në qytetin e Durrësit, ndërsa po merrte kthesën, aty afër ka kaluar një motor me dy punonjës policie, të cilët i janë afruar mjetit dhe R ka humbur kontrollin, duke e shmangur ciklomotorin.

Punonjësit e policisë kanë bërë titur, duke i urdhëruar që të hapnin krahun dhe duke u shprehur se *“ja u tregonin ata”*, *“Do t’ju bënin letrat për atje”*. Pasi ndaloi mjetin, shtetasi R.M doli nga makina dhe ju tha policëve se çfarë kishin, ndërsa dy punonjësit e policisë e kanë kapur nga krahët dhe i thanë që do t’i shoqëronin në polici me arrogancë.

Pas komunikimit se do t’i drejtoheshin komisariatit me vullnet të lirë, aty mbërrin edhe babai i tyre, i cili nga ana e tij është përpjekur të qetësojë situatën, duke u bërë thirrje punonjësve të policisë se ai vetë është punonjës i Policisë së Shtetit dhe se do t’i shoqëronte vetë në komisariat. Një efektiv policie ka shtyrë edhe babain e tij, i cili është rrëzuar në trotuar.

Sipas R.M, punonjësit e policisë i kanë fyer dhe i kanë shtyrë, atë e morën me një makinë të policisë *“Shqiponja”* dhe vëllanë e tërhiqnin brutalisht, për ta futur në mikrobuzin e Shqiponjave. Në makinë përveç fyerjeve, goditjeve në trup, në kurriz e bark, R. shpjegon se ka marrë edhe kërcënime. Gjatë kohës së transportimit për në komisariat, ai referon se vëllai i tij K. ishte goditur edhe pse ishte i mitur, vetëm 16 vjeç. Ai ua ka bërë me dije punonjësve të policisë gjatë gjithë kohës faktin, se i vëllai ishte i mitur.

Në vijim të deklaratimit, në dhomën e shoqërimit, 9 punonjës policie, duke përfshirë edhe shefin e turnit të patrullës së përgjithshme Kastriot Karafili e morën R. dhe e çuan në ambientin e tualeteve, ku ushtruan dhunë psikologjike, verbale dhe fizike. Po ashtu, kanë dhunuar edhe vëllanë K. Dy nxitësit e dhunës ishin dy efektivët e policisë Klaosjent Aliaj dhe Hysen Shehi. Një nga policët e ka goditur edhe në syrin e djathtë më grusht R. Sipas tij, punonjësi i policisë Hysen Shehi e ka intimiduar, duke i thënë se për këtë do të hante 6 muaj burg.

Në Komisarlatin e Policisë, K e kanë çuar në një dhomë ku erdhi një punonjës policie, për të cilin më vonë mësoi se quhej Kastriot Karafili, i cili e kapi me duar në fytyrë, duke iu thënë policëve që ta fushnin brenda. Në dhomën e shoqërimit kanë ardhur dy punonjësit e policisë, të cilët e kanë qëlluar me shpulla dhe grushte në trup dhe në fytyrë, ku dhe i kanë çarë vetullën e i kanë nxirë sytë. Nga ana tjetër sipas deklaratimit të K.M, duke qenë në dhomën e shoqërimit, ai ka dëgjuar të vëllanë, R të bërtiste *“Mos më godisni”*.

Ndërsa, sipas deklarimeve të punonjësve të policisë Klaosjent Aliaj dhe Hysen Shehi, ka qenë shtetasi R.M që ecte me mjet në mesin e rrugës dhe në momentin e marrjes së kthesës është afruar pranë motorit që ishte me fenelina ndezur, gati për të bërë aksident, ndonëse e ka shmangur atë. Punonjësi i policisë Hysen Shehi iu ka thënë se “*çfarë po bëni*”, ndërsa ata u përgjigjën se “*çfarë ju duket vetja*”, dhe kanë përdorur fjalë fyese ndaj tyre. Ju është dhënë sinjali të ndalonin dhe pasi kanë ndaluar, nga mjeti kanë zbritur R dhe K.M, kurse efektiv i Hysen Shehi ju ka thënë të futeshin brenda dhe iu kërkoi kartat e identitetit, të cilat nuk ua dhanë. Atëherë punonjësit e policisë iu thanë që do t’i shoqëronin në komisariat, por djemtë i kapën nga bluzat, duke i shtyrë dhe përdorur fjalë fyese. Meqënëse situata po degradonte, kanë marrë shefin e turnit të patrullës së përgjithshme Kastriot Karafili, duke e sqaruar për situatën dhe kërkuar ardhjen e një patrulle tjetër. Pas rreth 20 m R ka ndaluar mjetin pasi pa babanë e tij, i cili sipas tyre, nuk u prezantua që ishte punonjës policie dhe po mendohej të qetësonte djemtë e tij.

Sipas punonjësve të policisë, në makinë K.M ka kapur për rrobash punonjësin Klaosjent Aliaj, duke i grisur bluzën dhe gjuante me shkelma nga këmbët, ndërsa R.M kundërshtoi prangosjen, duke qëlluar në fytyrë policët. Në Komisarlatin e Policisë Durrës, ata kanë dorëzuar dy të shoqëruarit dhe sipas tyre nuk kanë hyrë në dhomën e shoqërimit, të komisarlatit, e për rrjedhojë nuk kanë ushtruar dhunë ndaj K dhe R.M.

Sipas deklarimeve të shtetasit S.M, në datë 14.07.2019, ai ka qenë duke udhëtuar me biçikletë në rrugën “Kasëm Durrësi”, lagjia nr.6, dhe sa ka arritur në trotuar, afër vendngjarjes i është afruar djali i madh R, i cili po drejtonte mjetin tip benz të punës. Kishte hapur dritaren dhe i thotë se po e shoqëronin në polici, por nuk kishte bërë asgjë. Djali i vogël ishte në sediljen e parë, në sediljet e pasme qëndronin dy policë me uniformë rendi. I drejtohet djalit duke i thënë se “*çfarë problem ka*”? Ai shprehet se ju është prezantuar edhe punonjësve të policisë, por ata nuk i kishin kthyer përgjigje dhe vazhdonin të kërkonin ndihmë nga policia. Më pas, është afruar një patrullë e Shqiponjave, ku kanë zbritur një djalë e një vajzë. Gjatë kësaj kohe, dy punonjësit e policisë që ishin brenda në makinë janë kapur me duar me djalin e vogël, K. që ishte në sediljen e parë. U ka bërë thirrje me zë të lartë “*Mos e shani, mos e godisni, sepse është nën moshën 18 vjeç, është 16 vjeç dhe nuk është problem se ju ndihmoj unë t’ua sjellë në polici*”. Por dy punonjësit, që më vonë mori vesh se ishin Klaosjent Aliaj dhe Hysen Shehi nuk ndalonin, duke u konfrontuar me K.

Në këtë kohë, afrohet edhe një furgon i policisë me rreth 4-5 punonjës të policisë, njërin prej të cilëve ai e njihte, dhe quhej Arben Baku. Kur punonjësit e policisë dolën nga automjeti, u identifikua si punonjës policie dhe u theksoi se djali, K ishte i mitur. Njëri prej tyre, e shtyu dhe S u rrëzua me kurriz, duke dëmtuar bërrylat, pasi ra në asfalt. Mezi u ngrit, se ishte edhe i aksidentuar më parë në këmbën e majtë, në të cilën ka disa vida. I ka bërë thirrje R, të vazhdonte me mjetin e policisë për t’u shoqëruar në komisariat, i cili ashtu veproi, pa kundërshtuar dhe pa përdorur forcë.

Ndërsa K po e tërhiqnin disa punonjës policie, pasi pa se mbahej te rrobat e tyre. Atë po e shanin dhe me dhunë po e shoqëronin në furgonin e policisë. Dhuna ishte kryesisht grushte e shpulla. U ritheksoi se ishte i mitur. Sipas deklaratës së S.M, R nuk ka prekur polic me dorë se ka qenë në timon. Më pas, kur ka shkuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, ka kontaktuar me shefin e turnit të patrullës së përgjithshme Kastriot Karafili pasi e njihte, duke i thënë se pse duhej të ushtrohej kjo dhunë. Ai ishte përgjigjur me arrogancë që të largohej. Në lidhje me ngjarjen, shtetasi S.M deklaroi se vuri në dijeni

edhe bashkëshorten. Sipas tij, e kunata shtetasja E.L ka kontaktuar me Drejtorin e Policisë së Durrësit, duke insistuar për djalin e mitur që mbahej në ambientet e shoqërimit në komisariat.

Rreth orës 20<sup>00</sup> të datës 14.07.2019 shtetasi S.M ka kontaktuar me oficerin e policisë gjyqësore, Kastriot Gjoni për të dhënë deklaratimet e nevojshme për ngjarjen. Ai dhe shefi i turnit të patrullës së përgjithshme Kastriot Karafili, i bënë me dije se te urgjenca e spitalit ishin dy punonjësit e policisë, Klaosjent Aliaj dhe Hysen Shehi. Më vonë, kur ai shkoi në urgjencë, vuri re se ata i kishin bluzat e grisura.

Në orën 22<sup>00</sup> të po kësaj date K.M në prani të të atit, avokatit dhe psikologut, ka dhënë deklarinimin. Kur është sjellë nga dhomat e shoqërimit, i ati ka vërejtur se djali ka qenë i çarë në vetullën e majtë dhe ishte nxirë poshtë syrit të djathtë. Kur e kishte pyetur se si ishte bërë kështu, ai ishte përgjigjur se e kanë ndarë nga i vëllai edhe pse u thoshte që ishte adoleshent, e kanë goditur dhe sharë me fjalë të ndyra. K është shprehur se R e kishin futur në banjë dhe e kishin goditur disa efektivë bashkë. Pas dhënies së deklaratimeve, S ka marrë djalin (K.M) si dhe vendimet për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor për vete dhe djalin. Ai ka kërkuar shpjegime për djalin e madh R.M te përgjegjësi i shërbimit, por pa përgjigje. Në spital, K dhe S kanë marrë trajtim për dy orë. Pas insistimit të tij, djali i madh, R është shoqëruar për në spital. Më vonë, ai ka marrë kontakt me prokurorin dhe i ka bërë bëri prezent ngjarjen.

Shtetasi S.M referon se kur ka dalë nga gjendja e arrestit, djali i tij R ishte shprehur se e kishin goditur disa punonjës policie në tualet. Kishte një hematomë në syrin e djathtë. Sipas S, ai ka pasur edhe probleme, pasi trembet në gjumë dhe vuan psikologjikisht.

Avokati i ka sugjeruar të mbajnë një deklaratë noteriale pajtimi që të nxirrin djalin, R. Dy punonjësit e policisë, të cilët i kishte takuar në prezencë të avokatit ishin shprehur se do e gjenin ata noteren, për të bërë deklaratën. Më datë 16.07.2019, janë përpiluar tre deklarata noteriale (nr.2872 rep., nr.1252/1 kol., datë 16.07.2019 nga S.M; nr.2867 rep., nr.1248/1, datë 16.07.2019 nga V.M; dhe nr.2868 rep, nr.1249/2, datë 16.07.2019 nga R.M).

Ndërsa sipas deklaratave të punonjësve të policisë, ka qenë shtetasi S.M që ka insistuar për bërjen e deklaratës noteriale, duke iu kërkuar dhe të falur atyre.

Në deklaratimet e tij shtetasi Kastriot Karafili, shefi i turnit të patrullës së përgjithshme është shprehur së është njoftuar nga punonjësit e policisë Klaosjent Aliaj dhe Hysen Shehi, për situatën dhe më pas ka marrë dijeni, për ngjarjen e ndodhur. Kur i kanë sjellë R dhe K.M në komisariat, pasi është vënë në dijeni se një prej tyre ishte i mitur, e ka vendosur në dhomën e shoqërimit për të mitur. E ka takuar të miturin, K.M dhe i ka thënë: *“Je djalë polici dhe turp të kesh që ke kundërshtuar policët”*. Sipas tij, punonjësit e policisë kanë vepruar konform ligjit dhe se nuk kanë ushtruar dhunë fizike ndaj të shoqëruarve, K dhe R.M.

Kurse punonjësi i policisë Pjerin Prenga, i cili ditën e ngjarjes ka qenë duke kryer shërbimin në dhomat e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Durrës, ka shpjeguar se shtetasit R dhe K.M, i kanë sjellë mbi 7-8 punonjës policie, të cilët i kanë shoqëruar brenda ambientit të dhomave.

Në vijim, me qëllim kryerjen e një hetimi të thelluar, në kuadër të konstatimit të fakteve dhe deklarimeve të dhëna nga personat e sipërpërmendur është kërkuar administrimi i pamjeve filmike të kamerave të vëzhgimit në ambientet e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Durrës. Drejtoria Vendore e Policisë Durrës me shkresën nr.8346, datë 29.08.2019, ka vënë në dispozicion një CD me pamjet filmike të datës 14.07.2019, ku në pamjet e cam 02 shihen:

Në orën 15.18.18, hyn R.M i shoqëruar me tre punonjës policie, njëri prej të cilëve e shtyn dhe direkt më pas hyn edhe një tjetër.

Në orën 15.21.31, hyn në ambientet e shoqërimit K.M dhe bashkë me të hyjnë edhe 5 punonjës të tjerë policie.

Vërehet një numër i lartë dhe i pajustificuar, i forcave të policisë që hyjnë në ambientet e shoqërimit, ndër të cilët, ka punonjës policie që mundohen të largojnë punonjës të caktuar nga këto ambiente.

Pas pak minutash, fillojnë të dalin nga ambientet e shoqërimit punonjësit e policisë.

Nga provat e administruara sikurse janë, deklaratat e shtetasve R dhe K.M, faqja e regjistrit të personave të shoqëruar si dhe CD-së me pamjet filmike të datës 14.07.2019, konstatojmë një mospërputhje të kohës së veprimeve. Ndërsa ora e shënuar në faqen e regjistrit të personave të shoqëruar, për të dy shtetasit e sipërpërmendur është 16<sup>30</sup>, nga ana tjetër ora e regjistruar nga kamera e vendosur në ambientet e shoqërimit, tregon se R dhe K.M hyjnë në ambientet e shoqërimit përkatësisht në orën 15.18.18 dhe 15.21.31 të pasdrekës, pra ndryshon për mbi 1 orë. (Mendojmë se ky ndryshim mund të vijë për arsye se ora e sistemit të monitorimit të ambienteve të jetë e pandryshuar. Kjo nisur dhe nga fakti se shtetasit e shoqëruar R dhe K.M kanë deklaruar se ngjarja ka ndodhur rreth orës 16<sup>30</sup>, që përputhet me orarin e shënuar në regjistrin e personave të shoqëruar. Por përsëri ka një mospërputhshmëri prej disa minutash).

Nga verifikimet e kryera në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe përgjigja e shkresës nr.894/4 datë 27.09.2019, ka rezultuar mbi bazën e materialeve referuese të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, më datë 15.07.2019 se është regjistruar çështja penale nr.1352 për veprën penale “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*” e kryer në bashkëpunim në ngarkim të shtetasve R dhe K.M.

Gjatë procesit të pyetjes, nga ana e shtetasit nën hetim R.M është pretenduar se është goditur nga punonjësit e policisë në ambientet e Komisarariatit të Policisë. Për këtë po kryhen veprimet hetimore përkatëse.

Nga ana e policisë gjyqësore është proceduar me arrestimin në flagrancë të shtetasit R.M dhe sipas procedurave ligjore, me vendimin nr.191, datë 17.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur vleftësimi i ligjshëm i arrestit të flagrancës dhe caktimi i masës së sigurimit, detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore për shtetasin R.M sipas nenit 234, të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti dhe nga provat shkresore të administruara nga ana jonë sikurse janë: Deklarimet e shtetasve R.M, K.M dhe S.M; Aktet e ekspertimit mjeko-ligjor nr.301, 302, 303, 306 dhe 307 datë 15.07.2019; Kopje të regjistrit të personave të shoqëruar dhe atij për të ndaluar/arrestuarit në Komisariatin e Policisë Durrës dhe CD me pamjet filmike nga kamerat e vëzhgimit në ambientet e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Durrës, arrijmë në konkluzionin se, gjatë

veprimeve për shoqërimin e shtetasve R dhe K.M, si dhe brenda ambienteve të Komisarariatit të Policisë Durrës nga punonjësit e policisë janë konsumuar elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.

Në vlerësim të sa më sipër, konstatohet se punonjësit e policisë nuk kanë pasqyruar sjellje etike e profesionale në kryerjen e detyrës, e manifestuar kjo në tejkalim të ushtrimit të forcës, përdorimit të pajustificuar të dhunës verbale dhe fizike, ndodhur kjo veçanërisht në mjediset e dhomave të shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Durrës, për më tepër ndaj një të mituri.

Këto veprime, përbëjnë cenim të integritetit fizik dhe psikologjik të shtetasve R dhe K.M, të mbrojtur e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Kodi Penal, ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ndërsa, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, parashikon parimin e interesit më të lartë të fëmijës, po ashtu ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë synimi kryesor në çdo vendim që merret mbi jetën e fëmijës si nga institucionet shtetërore apo ato private. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim normal fizik dhe moral, si dhe për të gëzuar një jetë familjare dhe sociale të përshtatshme për fëmijën. Interesi më i lartë i fëmijës gjen zbatim në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren nga autoritetet publike dhe jopublike, si dhe nga gjykatat në lidhje me fëmijët.

Në rastin konkret, veprimet e punonjësve të policisë në kundërshtim me parimet e përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, kanë passjellë si rrjedhojë, dëmtime në zhvillimin e shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social të të miturit K.M.

Vlen të theksohet se organet kompetente kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e duhura, për të siguruar që personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitarë, Po ashtu, personat që administrojnë procesin e drejtësisë penale, për të mitur duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Kjo mënyrë sjelljeje e punonjësve të policisë, vjen në kundërshtim edhe me nenin 2, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ku shprehimisht parashikohet se: “*Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut*”; si dhe të nenit 94 të tij ku parashikohet se “*Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave.....*”

Në rastin e marrë në shqyrtim, vlerësojmë se organi i prokurorisë duhet të tregohet më kërkues në hetim, për të sqaruar pozitën procedurale si të autorit të dyshuar, për kryerjen e veprës penale, ashtu dhe ndaj punonjësve të policisë që kanë ushtruar dhunë, me qëllim për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme. Është detyrimi ligjor i organit të Prokurorisë, për të kryer hetime të gjithanshme dhe objektive për të verifikuar pretendimet e personave nën hetim, për sjellje dhe veprime të paligjshme të kryera nga

punonjësit e Policisë së Shtetit, si dhe për të hetuar rrethana dhe fakte që janë në favor të personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet.

Gjithashtu, çmobjmë se organi i akuzës, duhet të reflektojë në respektimin më të mirë, të të drejtave të njeriut. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), ka bërë rekomandime konkrete në raportin për Shqipërinë të botuar gjatë vitit 2019<sup>1</sup>, në lidhje me faktin se hetimet nga prokuroria për rastet e dhunës, duhet të hetohen me shpejtësi e efikasitet dhe të ndara nga hetimet për akuzat e ngritura ndaj personit në konflikt me ligjin, ndaj të cilit është ushtuar dhunë.

Në raportin e lartpërmendur, CPT ka vërejtje për faktin se shqyrtimi i pretendimeve, për keqtrajtim të policisë, i kishte kaluar të njëjtit prokuror, që ishte përgjegjës për hetimin penal kundër personit, i cili pretendohet se është keqtrajtuar. Sipas CPT-së, një përgjegjësi e tillë e dyfishtë mund, të cenojë paanshmërinë e prokurorit në fjalë. Prandaj, Komiteti rekomandon që raste të keqtrajtimin të mundshëm të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara.

Ndërsa në pjesën e raportit që ka të bëjë me Policinë e Shtetit, CPT rekomandon se është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

Në pikën 15 përshkruhet se, përbërës thelbësor i çdo strategjie, për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente, i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse, nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cenuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla, duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

Policimi konsiderohet si manifestim i dukshëm i autoritetit shtetëror, ku ndër detyrat më të rëndësishme të saj, është dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj dhe shërbimet policore, duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Oficerët e policisë duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme dhe se ajo mund të përdoret vetëm në rast të kapjes së një personi. Pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”*,

<sup>1</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. <https://ëëë.coe.int/en/ëëb/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>



dhe në nenin 21/ç të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se: “i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale”:

### **REKOMANDOJMË:**

Fillimin e hetimeve ndaj punonjësve përgjegjës të policisë të Komisarariatit të Policisë Durrës, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar në dëm të shëndetit të shtetasve R dhe K.M, hetime të cilat të kryhen në përputhje me udhëzimet e CPT-së.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, lutemi të vihemi në dijeni brenda një afati të përshtatshëm.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë në cilësinë e provave fotokopje të njehsuara të dokumentave të mëposhtme:

- Deklarimet e shtetasve R.M, K.M, S.M dhe V.M;
- Deklarimet e punonjësve të policisë Hysen Shehi, Klaosjent Aliaj, Kastriot Karafili dhe Pjerin Prenga;
- Aktet e ekspertimit mjeko-ligjor nr.301, 302, 303, 306 dhe 307 datë 15.07.2019;
- Kopje të regjistrit të personave të shoqëruar dhe atij për të ndaluar/arrestuarit në Komisarariatit të Policisë Durrës etj;
- Fotografi të personave të dëmtuar;
- Një CD me pamje filmike nga kamerat e vëzhgimit në ambientet e shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Durrës;
- Raportin e shërbimit datë 14.07.2019;
- Deklarata noteriale 3 copë.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela RUSPI**